



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 350/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovice, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës dega ne Mitrovice për shkak te parregullsive gjate procesit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike te Kosovës dega ne Mitrovicë

Arsyetim

PZAP-i, me datën 11.06.2014 ka pranuar një ankesë nga PDK-ja dega Mitrovice në të cilën theksohet se me datën 08.06.2014 rreth orës 17:00, është konstatuar shkelje e nenit 33 dhe 36 te Ligjit për zgjedhje te Përgjithshme, me ç' rast dëshmitarët Besfort Azemi dhe Artan Mitari gjate kalimit afër shkollës fillore "Ismail Qemali" (qendra e votimit nr1104b) në Mitrovice ka vërejtur se Këshilltari i Kuvendit te Komunës se Mitrovicës Festim Kutllovc i thyer heshtjen zgjedhore duke i ftuar qytetaret e pranishëm ne atë lokacion për te votuar subjektin politik te LDK-se ne. Këto veprime sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregullat Zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore të subjektit politik PDK, janë të pabazuara pasi që ankesës ne fjale nuk i ka bashkangjitur asnjë provë me te cilën mund te vërtetohen shkeljet e supozuara nga personi ne fjalë. Andaj një pretendim i tillë është i pa bazuar dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe në bazë të nenit 3.6 pika (b) Rregullave dhe Procedurave te PZAP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 350/2014 më datën 12.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.